

SHTOJCË NR. 2

Datë: 04.02.2020

Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan”

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër më një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan”, me fond të marrëveshjes kuadër në verën prej 81,401,951 (tetëdhjetë e një milion e katërqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH dhe REF-46137-12-13-2019, hartoi këtë shtojcë për ndryshime të dokumenteve të tenderit si më poshtë:

Tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”:

Tek pika 3.3, Kapaciteti teknik, nënpika 4:

ISHTE:

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguar për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.
- Listëpagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.

BËHET:

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguar për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.
- Listëpagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.

Në zbatim të pikës 2/1 të nenit 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), për procedurën e prokurimit Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër më një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4

(katër) vite, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan”, me fond të marrëveshjes kuadër në verën prej 81,401,951 (tetëdhjetë e një milion e katërqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH dhe REF-46137-12-13-2019, afati kohor për dorëzimin e ofertave, shtyhet për në datën 10.02.2020 ora 11:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.